



BULETINI I PROKURORISË THEMELORE NË GJILAN

Tetor - Dhjetor 2024



Përmes këtij buletini do të pasqyrohen aktivitetet kryesore, të cilat janë realizuar në Prokurorinë Themelore në Gjiçë, për periudhën kohore Tetor - Dhjetor 2024.

Prokuroria Themelore në Gjilan gjatë muajit shtator ka ngritur 14 aktakuza për dhunë në familje

Gjilan, 1 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë muajit shtator 2024 ka pranuar njëzetepesë (25) kallëzime penale ndaj njëzeteshtatë (27) personave, për veprën penale “Dhuna në familje”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),

Nga këto raste të pranuar njëzetedy (22) viktima janë të gjinisë femërore, ndërsa, pesë (5) viktima të gjinisë mashkullore.

Gjatë këtij muaji nga prokurorët e Prokurorisë Themelore në Gjilan janë ngritur katërbëdhjetë (14) aktakuza, ndaj katërbëdhjetë (14) personave, për këto raste penale.

Prokuroria Themelore Gjilan

Prokuroria Themelore në Gjilan
gjatë muajit shtator ka ngritur
14 aktakuza për dhunë në familje

1 tetor 2024



Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Gjilan

Gjilan, 7 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 30 shtator – 6 tetor 2024, ka regjistruar gjithsej pesëdhjetegjashtë (56) kallëzime penale, ndaj gjashtëdhjetedy (62) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- dyzetekatër (44) aktakuza, ndaj pesëdhjetenjë (51) personave,
- tridhjetegjashtë (36) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- pesë (5) ankesa,
- gjashtë (6) kërkesa për shitje të aseteve,
- tre (3) persona të ndaluar,
- tri (3) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj tre (3) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar njëzetetë (28) persona.



Kërkohet paraburgim ndaj 2 personave për falsifikim të parasë, falsifikim të dokumentit dhe tregti të ndaluar

Gjilan, 10 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka kërkuar caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurve L.F. dhe H.I., në kohëzgjatje prej 30 ditësh, nga Gjykata Themelore në Gjilan.

Sipas kërkesës, i pandehuri L.F., më datën 9 tetor 2024, në komunën e Kamenicës, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror ka zhvilluar veprimtari të paautorizuar të shitblerjes së produkteve duke shmangur taksat e obligueshme, ashtu që pas kontrollit nga Njësia e Task Forcë DRK - Lindja, në veturën e tij janë gjetur 14 paketime, me 700 boksa cigare të llojit Winston, pa dokument apo faturë mbi prejardhjen e mallit, në vlerë rreth 14.700 euro, të cilat ka pasur për qëllim që përmes rrugëve ilegale ti dërgonte në Serbi.

Me këto veprime dyshohet për veprën penale "Tregtia e ndaluar", të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Po ashtu, i njëjti dyshohet edhe për veprën penale "Falsifikimi i dokumentit", të KPRK-së, pasi që ka përdorur pasaportë të falsifikuara.

Ndërsa, i pandehuri H.I., dyshohet për veprën penale "Shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore", të KPRK-së, pasi që gjatë kontrollit tek shtëpia e të njëjtit janë gjetur paketime të ndryshme të cigareve, pa dokumentacion përcjellës për prejardhjen e mallit.

Gjithashtu, i pandehuri H.I., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, ka vënë në qarkullim para të falsifikuara, ashtu që tek i njëjti janë gjetur edhe monedha metalike nga 2 euro, në vlerë të përgjithshme 640 euro.

Me këto veprime dyshohet se i pandehuri H.I., ka kryer veprën penale "Falsifikimi i parasë", të KPRK-së.

Me urdhër të prokurorit të shtetit, të njëjtit gjenden nën masën e ndalimit 48 orësh.



Pasqyrim javor nga Prokuroria Themelore në Gjilan

Gjilan, 14 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 7 – 13 tetor 2024, ka regjistruar gjithsej pesëdhjetetë (58) kallëzime penale, ndaj gjashtëdhjeteshtatë (67) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- pesëdhjetetri (53) aktakuza, ndaj gjashtëdhjetë (60) personave,
- tridhjetedy (32) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- dy (2) ankesa,
- tetë (8) propozime për shqiptimin e masave ndaj të miturve,
- gjashtë (6) persona të ndaluar,
- tri (3) kërkesa për caktimin e masës së paraburgimit ndaj tre (3) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar tridhjetë (30) persona.



Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Gjilan

Gjilan, 21 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 14 - 20 tetor 2024, ka regjistruar gjithsej tridhjetenjë (31) kallëzime penale, ndaj tridhjetetë (38) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- tridhjetedy (32) aktakuza, ndaj tridhjetenëntë (39) personave,
- tridhjetepesë (35) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- shtatë (7) ankesa,
- katër (4) propozime për shqiptimin e masave ndaj të miturve,
- katër (4) marrëveshje për pranimin e fajësisë,
- njëmbëdhjetë (11) persona të ndaluar,
- tetë (8) kërkesa për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, ndaj njëmbëdhjetë (11) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar tridhjetenëntë (39) persona.



Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Gjilan

21 tetor 2024

31 Kallëzime penale të regjistruara

7 Ankesa

32 Aktakuza

11 Persona të ndaluar

35 Aktvendime

39 Persona të intervistuar

Kryeprokurori Kadriu priti në takim përfaqësues të KFOR-it amerikan

Gjilan, 22 tetor 2024

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, z. Arben Kadriu ka pritur në takim përfaqësues nga Zyra Ligjore e KFOR-it amerikan, major z. Tony May dhe kapitenen znj. Laura Eckstein.

Gjatë këtij takimi ishte i pranishëm edhe zëvendës kryeprokurori i kësaj prokurorie, z. Isuf Sadiku.

Kryeprokurori Kadriu, fillimisht falënderoi përfaqësuesit e KFOR-it për angazhimin, përkushtimin dhe bashkëpunimin e tyre në mbështetje të këtij regjioni, duke vlerësuar rolin e tyre në ruajtjen e sigurisë, paqes dhe stabilitetit, gjatë përmbushjes së detyrave të tyre.

Në anën tjetër, të pranishmit falënderuan Prokurorinë Themelore në Gjilan për pritjen dhe bashkëpunimin, duke theksuar se mbeten të përkushtuar në misionin e tyre paqeruajtës, në sigurinë dhe stabilitetin e vendit.

Në fund të takimit të njëjtit u shprehën të gatshëm për bashkëpunim të mëtutjeshëm me Prokurorinë Themelore në Gjilan, me qëllim të kontributit në sigurimin e paqes.



Përmbledhje e punës javore nga Prokuroria Themelore në Gjiilan

Gjiilan, 28 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjiilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 21 - 27 tetor 2024, ka regjistruar gjithsej pesëdhjetepesë (55) kallëzime penale, ndaj gjashtëdhjetenjë (61) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- tridhjetetri (33) aktakuza, ndaj tridhjeteshtatë (37) personave,
- dyzet (40) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- tri (3) ankesa,
- tetë (8) persona të ndaluar,
- tetë (8) kërkesa për caktimin e paraburgimit, ndaj tetë (8) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar njëzetepesë (25) persona.



Aktakuzë ndaj 3 personave për vrasje të rëndë në tentativë dhe armëmbajtje pa leje

Gjilan, 30 tetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë ndaj tre (3) personave, të pandehurve N.H., N.B. dhe A.B.

Sipas aktakuzës, i pandehuri N.H., më 8 Gusht 2024, në komunën e Vitisë, me dashje ka tentuar të privojë nga jeta të pandehurit N.B. dhe A.B., duke rrezikuar edhe persona të tjerë që ndodheshin në të njëjtin vend, ashtu që për shkak të një mosmarrëveshje për blerjen e një prone, me armë automatike gjuan drejt tyre, me ç'rast të pandehurit N.B., i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore, ndërsa, të pandehurit A.B. lëndime të lehta trupore, ku me këto veprime ka kryer veprën penale "Vrasja e rëndë në tentativë", të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

I njëjti po ashtu akuzohet edhe për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", të KPRK-së, pasi pa autorizim ka mbajtur në pronësi armë zjarri të markës AK-47.

I pandehuri N.B., në datën dhe vendin e lartcekur, ka tentuar ta privoj nga jeta të pandehurin N.H., duke vënë në rrezik edhe jetën e të dëmtuarës V.H., e cila ishte në të njëjtin vend, ashtu që me armë zjarri gjuan në drejtim të tij, por nuk arrin që ta qëllojë, ku me këto veprime ka kryer veprën penale "Vrasja e rëndë në tentativë", të KPRK-së.

Gjithashtu, i njëjti akuzohet edhe për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", të KPRK-së, pasi pa autorizim ka mbajtur në pronësi armën e zjarrit të markës SIG 14.

Ndërsa, i pandehuri A.B., akuzohet për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", të KPRK-së, pasi gjatë kontrollit në shtëpinë e tij është gjetur një pushkë gjuetie e markës CIF-San, të cilën e posedonte pa leje valide.



Përmbledhje e punës javore

Gjilan, 4 nëntor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 28 tetor – 3 nëntor 2024, ka regjistruar gjithsej njëzetënëntë (29) kallëzime penale, ndaj tridhjetepesë (35) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- tridhjetekatër (34) aktakuza, ndaj dyzet (40) personave,
- tridhjetedy (32) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- tetë (8) ankesa,
- tre (3) persona të ndaluar,
- tri (3) kërkesa për caktimin e paraburgimit, ndaj tre (3) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar tridhjetekatër (34) persona.

**Prokuroria Themelore
Gjilan**

Përmbledhje e punës javore
28 tetor - 3 nëntor 2024

- 34** Aktakuza
- 32** Aktvendime
- 29** Kallëzime penale të regjistruara
- 8** Ankesa
- 3** Kërkesa për caktimin e paraburgimit
- 34** Persona të intervistuar

NJOFTIM PËR MEDIA

Gjilan, 7 nëntor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, ju njofton se gjatë ditës së sotme, më datë 7 nëntor 2024, në rrugën ‘Mërgimtarët e Gjilanit’, në Gjilan, rreth orës 14h, një person është gjetur pa shenja jete.

Prokurori kujdestar nga Departamenti për Krime të Rënda dhe njësitet tjera relevante menjëherë kanë dalë në vendin e ngjarjes, ku nga hetimet e para dyshohet se viktima është qëlluar me armë zjarri dhe me urdhër të prokurorit trupi i pa jetë është dërguar për autopsi në Institutin e Mjekësisë Ligjore.

Prokuroria Themelore në Gjilan, në koordinim me Policinë e Kosovës – Njësinë e Hetimeve Rajonale në Gjilan, janë duke ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore, në mënyrë që të identifikohen personat e dyshuar.

Për të gjitha veprimet e tjera do të jeni të njoftuar me kohë!

Përmbledhje e punës javore

Gjilan, 11 nëntor 2024


Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 4 - 10 nëntor 2024, ka regjistruar gjithsej tridhjetekatër (34) kallëzime penale, ndaj dyzet (40) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- dyzetedy (42) aktakuza, ndaj dyzetekatër (44) personave,
- njëzetënëntë (29) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- pesëdhjetetri (53) kërkesa të ndryshme drejtuar policisë,
- katër (4) ankesa,
- katër (4) propozime për shqiptimin e masave ndaj të miturve,

- katër (4) persona të ndaluar,
- katër (4) kërkesa për masa të sigurisë së pranisë së të pandehurit në procedurë penale, ndaj katër (4) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar tridhjetë (31) persona.



Kërkohet paraburgim ndaj dy personave për vrasje të rëndë dhe armëmbajtje pa leje

Gjilan, 13 nëntor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit, në Gjykatën Themelore në Gjilan, ndaj të pandehurve V.S. dhe F.M., për shkak të dyshimit të veprave penale “Vrasja e rëndë” dhe “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Sipas kërkesës, ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit V.S. dhe F.M., me datën 7 nëntor 2024, rreth orës 13:55 minuta, në rrugën „Mërgimtarët e Gjilanit”, në Gjilan, kanë privuar nga jeta tani të ndjerin S.O., në atë mënyrë që pas marrëveshjes paraprake, e kanë përcjellë të njëjtin duke i’u vu pas me biçikleta, me ç’rast pasi i ndjeri ka dalë nga vetura, afrohen të pandehurit dhe nga afërsia i pandehuri V.S., gjuan një herë me armë në drejtim të tij në anën e majtë mbrapa shpinës, i cili për shkak të plagës ka ndërruar jetë në vendin e ngjarjes, ku më pas ikin në drejtim të panjohur.

Me këto veprime, të njëjtit në bashkëkryerje dyshohet se kanë kryer veprën penale “Vrasja e rëndë”, të KPRK-së.

I pandehuri V.S., dyshohet edhe për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, të KPRK-së, pasi pa autorizim, ka mbajtur në pronësi armë zjarri, e cila është sekuestruar.

Të pandehurit e lartshënuar me urdhër të prokurorit gjenden nën masën e ndalimit 48 orësh.



Brenda javës 9 persona të ndaluar

Gjilan, 18 nëntor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 11 - 17 nëntor 2024, ka regjistruar gjithsej tridhjeteshtatë (37) kallëzime penale, ndaj dyzetegjashtë (46) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- tridhjetekatër (34) aktakuza, ndaj dyzet (40) personave,
- tridhjetetetë (38) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- dyzetekatër (44) kërkesa të ndryshme drejtuar policisë,
- shtatë (7) ankesa,
- nëntë (9) persona të ndaluar,
- pesë (5) kërkesa për masa të sigurisë së pranisë së të pandehurit në procedurë penale, ndaj nëntë (9) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar njëzetetetë (28) persona.



Prokuroria Themelore në Gjilan brenda javës paraqet 11 propozime për shqiptimin e masave ndaj të miturve

Gjilan, 25 nëntor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 18 - 24 nëntor 2024, ka regjistruar gjithsej tridhjetegjashtë (36) kallëzime penale, ndaj dyzetedy (42) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- njëzeteshtatë (27) aktakuza, ndaj njëzeteshtatë (27) personave,
- tridhjetedy (32) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- dyzet (40) kërkesa të ndryshme drejtuar policisë,
- njëmbëdhjetë (11) ankesa,
- njëmbëdhjetë (11) propozime për shqiptimin e masave ndaj të miturve,
- katër (4) persona të ndaluar,
- katër (4) kërkesa për masa të sigurisë së pranisë së të pandehurit në procedurë penale, ndaj katër (4) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar tridhjeteshtatë (37) persona.



**Prokuroria Themelore
Gjilan**

Prokuroria Themelore në Gjilan brenda javës paraqet 11 propozime për shqiptimin e masave ndaj të miturve

25 nëntor 2024

- 27 aktakuza
- 11 propozime për shqiptimin e masave ndaj të miturve
- 11 ankesa
- 32 aktvendime
- 37 persona të intervistuar
- 36 kallëzime penale të regjistruara

64 persona të akuzuar brenda javës nga Prokuroria Themelore në Gjilan

Gjilan, 2 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 25 nëntor – 1 dhjetor 2024, ka regjistruar gjithsej njëzetekatër (24) kallëzime penale, ndaj njëzetënëntë (29) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- pesëdhjetë (50) aktakuza, ndaj gjashtëdhjetekatër (64) personave,
- tridhjetetë (32) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- dyzetetë (48) kërkesa të ndryshme drejtuar policisë,
- pesë (5) ankesa,
- katër (4) marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar dyzetedy (42) persona.



Prokuroria Themelore në Gjilan gjatë muajit nëntor ka ngritur 16 aktakuza për dhunë në familje

Gjilan, 4 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë muajit nëntor 2024, ka pranuar dymbëdhjetë (12) kallëzime penale, ndaj dymbëdhjetë (12) personave, për veprën penale ‘Dhuna në familje’, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),

Gjatë kësaj periudhe kohore, nga Departamenti Përgjithshëm i kësaj prokurorie janë ngritur gjithsej gjashtëmbëdhjetë (16) aktakuza, kundër gjashtëmbëdhjetë (16) personave, për veprën penale ‘Dhuna në familje’.

Ndërsa, nga Departamenti për të Mitur është paraqitur një (1) propozim për shqiptimin e masës edukative, ndaj një (1) personi të mitur, për këtë veprë penale.



Aktakuzë për vrasje në tentativë

Gjilan, 5 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurit B.H., për shkak të veprës penale “Vrasja në tentativë”, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas aktakuzës, i pandehuri B.H., me datën 23 tetor 2024, në komunën e Vitisë, ka tentuar ta privoj nga jeta të dëmtuarin R.E., në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshjeve verbale që kanë pasur mes vete, i pandehuri me mjet të përshtatshëm, me thikë e ka goditur të dëmtuarin në anën e majtë të kraharorit, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore.

I pandehuri i lartshënuar, me kërkesë të Prokurorisë Themelore në Gjilan gjendet nën masën e paraburgimit prej datës 23 tetor 2024.



32 aktakuza dhe 10 propozime për shqiptimin e masave ndaj të miturve brenda javës nga Prokuroria Themelore në Gjilan

Gjilan, 9 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 2 - 8 dhjetor 2024, ka regjistruar gjithsej njëzetënjë (21) kallëzime penale, ndaj njëzetepesë (25) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- tridhjetedy (32) aktakuza, ndaj tridhjetetre (33) personave,
- njëzetedy (22) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- dhjetë (10) propozime për shqiptimin e masave ndaj të miturve,
- gjashtëdhjetedy (62) kërkesa të ndryshme drejtuar policisë,
- tri (3) ankesa,
- një (1) person i ndaluar,
- një (1) kërkesë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj një (1) personi,

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar tridhjetetre (33) persona.



Prokuroria Themelore në Gjilan organizon tryezë me temë “Roli i organeve kompetente në mbrojtjen e mjedisit, kafshëve, bimëve dhe monumenteve kulturore”

Gjilan, 10 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, përkatësisht prokurorja Rozelida Manastiri, njëherit edhe koordinatore për veprat penale kundër ambientit, në kuadër të Prokurorisë Themelore në Gjilan, në bashkëpunim dhe mbështetje të OSBE-së, ka organizuar tryezë diskutimi me temën “Roli i organeve kompetente në mbrojtjen e mjedisit, kafshëve, bimëve dhe monumenteve kulturore”.

Gjatë këtij takimi pjesëmarrësit paraqitën arritjet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen institucionet përkatëse dhe në bazë të diskutimeve u arrit konsensus për themelimin e një mekanizmi bashkëpunues mes institucioneve për luftimin e veprave penale në fushën e mbrojtjes së mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore.

Qëllimi i kësaj tryeze ka qenë koordinimi ndërinstitucional për parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e veprave penale që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, duke theksuar krijimin e një mekanizmi efektiv, i cili jo vetëm ndëshkon shkeljet, por edhe promovon mbrojtjen e pasurive natyrore dhe kulturore.



35 persona të akuzuar brenda javës nga Prokuroria Themelore në Gjilan

Gjilan, 16 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 9 - 15 dhjetor 2024, ka regjistruar gjithsej gjashtëdhjetë (60) kallëzime penale, ndaj gjashtëdhjetë (63) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- tridhjetenjë (31) aktakuza, ndaj tridhjetepesë (35) personave,
- tridhjetekatër (34) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- gjashtë (6) propozime për shqiptimin e masave ndaj të miturve,
- gjashtë (6) ankesa,
- katër (4) persona të ndaluar,
- tri (3) kërkesa për sigurimin e pranisë së të pandehurve në procedurë penale.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar tridhjetë (33) persona.



Prokuroria Themelore në Gjilan brenda javës ka intervistuar 46 persona

Gjilan, 23 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 16 - 22 dhjetor 2024, ka pranuar gjithsej tridhjetë (30) kallëzime penale.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- gjashtëdhjetë (62) aktakuza, ndaj gjashtëdhjetë (67) personave,
- tridhjetë (38) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- tri (3) propozime për shqiptimin e masave ndaj të miturve,
- katër (4) ankesa,
- katër (4) persona të ndaluar,
- katër (4) kërkesa për caktimin e paraburgimit, ndaj katër (4) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar dyzetegjashtë (46) persona.



Prokuroria Themelore në Gjilan brenda javës ka ndaluar 19 persona

Gjilan, 30 dhjetor 2024

Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë javës së fundit, përkatësisht nga data 23 - 29 dhjetor 2024, ka pranuar gjithsej njëzet (20) kallëzime penale, ndaj njëzetekatër (24) personave.

Gjithashtu, gjatë kësaj jave janë proceduar:

- tridhjetetë (38) aktakuza, ndaj tridhjetenëntë (39) personave,
- njëzetedy (22) aktvendime (përfshirë aktvendime për fillimin e hetimeve, për fillimin e procedurës përgatitore, për pushimin e hetimeve, zgjerimin e hetimeve, për hedhje të kallëzimit penal, aktvendime të ekspertëve mjeko – ligjor, aktvendim për ekzaminime),
- gjashtë (6) ankesa,
- nëntëmbëdhjetë (19) persona të ndaluar,
- njëmbëdhjetë (11) kërkesa për sigurimin e pranisë së të pandehurve në procedurë penale, ndaj nëntëmbëdhjetë (19) personave.

Nga prokurorët e kësaj prokurorie gjatë kësaj periudhe kohore janë intervistuar njëzetegjashtë (26) persona.

